



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
MIRATIMIN E SASISË SË VULAVE REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT QË DO
TË PRODHOHEN PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ
2023

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenin 103, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 19.2.2021, të Komisionit Rregullator, i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 11, datë 28.12.2020 “Për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”, ka caktuar rregullat për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë në Komisionet e Qendrave të Votimit.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 5, datë 19.2.2021 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 28.12.2020”, ka përcaktuar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, prodhon vula rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së KQV-së apo vulës së kryetarit të KQV-së, të nxjerrë nga përdorimi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përcakton:

- a) Numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi;
- b) Formatin, tekstin dhe numrin serial të çdo vule rezervë;

Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 9, datë 25.1.2022, ka miratuar sasinë 10% copë vula rezervë. Duke vlerësuar reduktimin e kërkesave buxhetore, në vendimin nr. 59, datë 10.2.2022 “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore për



zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022” si dhe duke u mbështetur në analizën historike të të dhënave lidhur me numrin e kufizuar të rasteve që ky material zgjedhor është përdorur në zgjedhjet pararendëse, diktohet ulja e sasisë së vulave rezervë të KQV-ve. Bazuar në analizën e riskut vlerësohet që sasia e vulave rezervë të KQV-ve në të cilat do të zhvillohen zgjedhjet e pjesshme vendore do të jetë në masën e përafërt prej 10% QV-ve të cdo KZAZ-je, në sasinë prej 520 vula.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Daniela ALIMEMETI - Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit

Majlinda ÇELMETA - Drejtoria e Përgjithshme e Administrimit të Zgjedhjeve

Ylli MERKAJ - Sekretar i Përgjithshëm





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 00.00.2023

Nr: 00

Ora: 00:00

PROJEKTVENDIM

PËR

**MIRATIMIN E SASISË SË VULAVE REZERVË TË KOMISIONIT TË QENDRËS SË VOTIMIT QË
DO TË PRODHOHEN PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS
14 MAJ 2023**

Në mbështetje, të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 103, pikat 1 e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, të prodhohen 10% (520 copë) vula rezervë të KQV-së.
2. Teksti i vulës rezervë të KQV-së është unik për çdo vulë, dhe përbëhet nga shkronja “R” dhe një numër serial katër shifror.
3. Formatit dhe specifikimet e vulës rezervë të KQV-së janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
4. Dorëzimi i vulës dokumentohet nëpërmjet procesverbalit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 00.3.2023 Nr: 00
Ora: 00:00



“Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit që do të prodhohen për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Formati i Vulës: KQV - REZERVË



Legjenda:

1. Diametri = 38 mm
2. Stema e Republikës së Shqipërisë
3. tekst: Republika e Shqipërisë
4. tekst: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
5. Komisioni i Qendrës së Votimit
6. Numri i identifikimit, tekst: REZERVË, R-0000/01
7. tekst: Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023



MODEL

Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 14 maj 2023

PROCESVERBAL KZAZ - KQV

Për dorëzimin në KQV të vulës rezervë

KZAZ Nr:

KQV

Datë:

Ora:

Baza Ligjore: Neni 103, pika i ligjit 10 019, datë 29.12.2008 ' Kodi Zgjedhor I Republikës Së Shqipërisë' i ndryshuar

	Ekzemplari i vulës së KQV-së rezervë
Sot më datë , në qendrën e votimit nr. , ZAZ , Qarku , u dorëzua vula rezervë me numrin e identifikimit REZERVË Kjo vulë do të përdoret për të zëvendësuar vulën e nxjerrë jashtë përdorimit të: ☐ Vulës së KQV-së ☐ Vulës së kryetarit të KQV-së	Vula

Dorëzuesi nga KQZ / KZAZ**Marrësi në Dorëzim nga KQV**Kryetar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

(emër, mbiemër, firmë)

Sekretar: _____
(emër, mbiemër, firmë)

Vula